

# **KUADRI LIGJOR MBI SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË DHE SFIDAT NËPËRMJET IMPLEMENTIMIT**

Eda Beqiri, Shefe e sektorit të Shëndetit  
dhe Sigurisë në punë  
**Inspektoriati Shtetëror i Punës**



## **Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore**

**Inspektorati Shtetëror i Punës është një garanci për të ruajtur paqen sociale dhe për të siguruar qëndrueshmërinë e tregut të punës, pra është një faktor i rëndësishëm dhe i pazëvendësueshëm në zhvillimin dhe konsolidimin e ekonomisë së tregut.**

**Nisur nga njohja e së drejtës që kanë punëmarrësit në mjediset e punës për mbrojtjen e shëndetit dhe integritetit të tyre, janë hartuar politika kombëtare dhe Legjislacioni për Sigurinë e Shëndetit në Punë, i pasuar nga një varg aktesh nënligjore dhe rregullore, të cilat përcaktojnë detyrimet përkatëse që mjediset e punës të garantojnë këtë të drejtë.**



## **Legjislacioni aktual për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë**

**Shtyllat kryesore që garantojnë mbrojtjen në punë të punëmarrësve:**

- Ø Kushtetuta e RSH.**
- Ø Kodi i Punës**
- Ø Dokumenti Strategjik Ndër-sektorial për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 2016-2020.**
- Ø Ligji i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, VKM-të dhe Rregulloret përkatëse të dala në zbatim të tij.**

**ISHPSHSH është institucioni kryesor përgjegjës për mbrojtjen në punë të punëmarrësve**



## **Legjislacioni aktual për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë**

- Në shkurt të vitit 2004, Shqipëria ratifikoi Konventën nr.155 të ILO-s “Siguria dhe Shëndeti në Punë” dhe si detyrim që rrjedh nga kjo Konventë dhe nga Direktiva Kuadër 89/391/EEC, u hartua dhe u miratua Ligji Nr.10237 date 18.02.2010 “Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”.
- Ligji i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë është plotësuar dhe me hartimin e miratimin e 24 akteve nënligjore që plotësojnë kërkesat themelore të sigurisë dhe shëndetit në punë në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe konventat e ILO-s.



# Masat e marra nga ISHPSHSH për zbatimin e Legjislacionit të Punës

- ISHPSH si institucioni kryesor përgjegjës për zbatimin e Legjislacionit të Punës dhe Ligjit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë e akteve nënligjore të dala në zbatim të tij gjatë vitit 2018 ka marrë një varg masash të domosdoshme për të përmirësuar punën dhe për të përmbushur sa më mirë misionin e tij.
- Konkretisht janë bërë;
- Rikonceptimi i Faqes Zyrtare
- [www.inspektoriatipunesh@sl.gov.al](mailto:www.inspektoriatipunesh@sl.gov.al) ka bërë që faqja zyrtare e ISHPSHSH-së të kthehet në një platformë informuese dhe ndërvepruese e aksesueshme edhe në gjuhën angleze, ku që në momentin e rindertimit të saj e deri me sot është vizituar nga 4699 përdorues. Kjo tregon se punëdhënësit e punëmarrësit kërkojnë të informohen dhe të kenë njohuri mbi procedurat e inspektimit dhe të drejtat dhe detyrimet që ata kanë.



# Masat e marra nga ISHPSHSH për zbatimin e Legjislacionit të Punës

- Ndryshimi i Faqes Zyrtare duke qenë tashmë i aksesueshëm për punëmarrësit, punëdhënësit dhe shërbimet ndaj tyre, krijon mundësi për aplikim online të:
  - Denoncimeve.
  - Ankimimeve.
  - Njoftimeve për aksidente në punë e sëmundje profesionale.
  - Kërkesa për Leje Pune.
  - Autorizime për kryerje pune jashtë kohës normale.
  - Autorizime për të punësuar të miturit.
  - Ankimime kundrejt vendimeve të inspektimit.
  - Informacione të tjera mbi inspektimin.



## **Masat e marra nga ISHPSHSH për zbatimin e Legjislacionit të Punës**

- Në faqen zyrtare të ISHPSHSH-së tashmë është integruar dhe është e aksesueshme edhe platforma “Matrica e Dënimeve”.
- Kjo platformë është projektuar me qëllim sigurimin e transparencës së vendimarrjes të inspektoreve të punës, pasi ishte konstatuar që nuk përdorej i njëjti standart për të gjithë shkelësit e ligjit. Duke e konsideruar si domosdoshmëri vendosjen e standarteve në procesin e inspektimit të punës, para se të kërkojmë zbatimin e standarteve të punësimit nga biznesi, përmes Platformës “Matrica e Dënimeve” synojmë;
- Të ulim në maksimum abuzimin me detyrën nga inspektorët e punës, duke e bërë procesin e vendimarrjes plotësisht transparent.
- Te ndikojmë drejtpërsëdrejti në rritjen cilësore të inspektimit të punës, duke e bërë atë sa më profesional.



# Masat e marra nga ISHPSHSH për zbatimin e Legjislacionit të Punës

- Ti japim punëdhënësve mundësinë e vetëkorrigjimit, mbasi ata mund të testojnë veten se në çfarë niveli janë në zbatimin e ligjit.
- Të mundësojmë trajtim të barabartë për sa i takon masës së sanksioneve kur konstatohen të njëjtat shkelje të dispozitave ligjore. E thënë më qartë, masë e njëjtë sanksioni për të njëjtën shkelje ligjore, në të njëjtat kushte.
- Të marrim informacion të plotë nga inspektimet e kryera, duke synuar hartimin e një metodologjie inspektimi sa më racionale bazuar në shkeljet e konstatuara.
- Të hartojme një rregjistër të subjekteve të inspektuara në vite, me tregues inspektimi dhe dispozita ligjore të shkelura, që do shërbejë si platformë e integruar edhe në “Matricën e dënimeve”.
- Të planifikojme dhe orientojmë inspektimet duke marrë parasysh jo vetëm intensitetin e shkeljes së dispozitave ligjore por edhe sektorët me risk të lartë për aksidente në punë dhe sëmundje profesionale.
- Të rrisim numrin e inspektimeve në subjektet me numër të konsiderueshëm punëmarrësish dhe që paraqesin probleme për sigurinë dhe shëndetin në punë.





## **Të dhëna nga inspektimet në lidhje me zbatimin e Ligjit të SSHP-së**

- Në vitin 2018 janë inspektuar 12 297 subjekte në të gjithë territorin e Shqipërisë, ku 80% e inspektimeve janë realizuar në periudhën maj-dhjetor 2018.
- Nga inspektimet e kryera në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë është konstatuar;
- Rritje të numrit të subjekteve ku ekziston Këshilli i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë. Konkretisht nga 860 subjekte të evidentuar në vitin 2017, në vitin 2018 janë evidentuar 925 subjekte me KSSHP.
- Rritje të numrit të subjekteve në të cilat ekziston Dokumenti i Vlerësimit të Riskut, ku nga 894 subjekte për vitin 2017, në 2018 janë evidentuar 2704 subjekte në të cilat ekziston ky dokument.



## **Të dhëna nga inspektimet në lidhje me zbatimin e Ligjit të SSHP-së**

- Rritje të numrit të subjekteve në të cilat përdoren paisjet mbrojtëse individuale, ku nga 2841 subjekte për vitin 2017, në 2018 janë evidentuar 6200 subjekte në të cilat përdoren PMI-të.
- Rritje të numrit të subjekteve në të cilat përdoren paisjet mbrojtëse kolektive, ku nga 2702 subjekte për vitin 2017, në 2018 janë evidentuar 5500 subjekte në të cilat përdoren PMK-të.
- Rritje të numrit të subjekteve që janë të paisur me mjek ndërmarrje, ku nga 1460 subjekte për vitin 2017, në 2018, janë evidentuar 1899 subjekte të cilat janë të mbuluara me shërbim mjekësor.
- Gjatë vitit 2018 janë regjistruar 162 raste aksidentesh në punë, në të cilat janë aksidentuar 195 punëmarrës ku nga këto, 27 me pasojë vdekje.



## **Të dhëna nga inspektimet në lidhje me zbatimin e Ligjit të SSHP-së**

- **Krahasuar me një vit më parë, rezulton rritje e numrit të aksidenteve në punë.**
- **Midis të tjerash, kjo rritje ka ardhur sepse me rritjen e transparencës së inspektimit, subjektet e kanë të vështirë të fshehin deklarinin e aksidenteve në punë i cili është detyrim ligjor dhe mosdeklarimi ka pasoja të rënda ligjore.**
- **Gjithashtu ndikim ka pasur dhe informacioni i shtuar, së bashku me krijimin e lehtësirave për këtë raportim.**
- **Vetëm nga faqja zyrtare, nga muaji Korrik 2018 janë deklaruar 11 raste aksidentesh në punë, duke mundësuar deklarinin të tyre në çdo ditë dhe orë të javës, përfshirë ditët e pushimit javor apo ditët e festave zyrtare.**
- **Rritja e numrit të aksidenteve konstatohet kryesisht në subjektet minerare si dhe aksidentet rrugore.**



## Bashkëpunimi Ndërinstitucional

Inspektorati i Punës ka bashkëpunuar me institucione të tjera si;

- ❖ Tatim-Taksat, Institutin e Sigurimeve Shoqërore, Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor, Policinë e Shtetit, Prokurorinë, AKSEM etj.
- ❖ Gjithashtu ISHPSHS ka bashkëpunuar me organizata të ndryshme të shoqërisë civile si Qendrën Shqiptare për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Qendrën për të Drejtat në Punë dhe Qendren per Aleancë Gjinore e Zhvillim në zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme.
- ❖ Me mbështetjen e Zyrës Ndërkombëtare të Punës ILO, gjatë periudhës Maj-Qershor 2018, është zhvilluar projekti PPÇS (Platforma e Punësimit dhe Çështjeve Sociale), i financuar nga Komisioni European me synimin, forcimi i inpektoriave të punës të Ballkanit Perëndimor për inspektimin në sektorin e ndërtimit.
- ❖ Rol të rëndësishëm në zhvillimin e sistemit të sigurisë e shëndetit në punë në Shqipëri ka dhënë Agjensia Europiane e Sigurisë e Shëndetit në Punë nëpërmjet Pikës Fokale. Ajo ka ndihmuar me botime e materiale të ndryshme për zhvillimin e fushatave ndërgjegjësuese në lidhje me sigurinë e shëndetin në punë.



# Mangësitë e konstatuara nga inspektimet në drejtim të SSHP-së

Nga inspektimet e kryera në drejtim të zbatimit të ligjit të SSHP-së konstatohet;

- Zbatimi i legjislacionit të SSHP kërkon ekspertë të SSHP-së dhe Shqipërisë i mungon kuadri ligjor për përgatitjen dhe certifikimin e tyre, për rrjedhojë në shumicën e rasteve Sistemi i Sigurisë e Shëndetit në Punë, hartimi i Dokumentit të Vlerësimit të Riskut etj. në nivel kompanie hartohen dhe menaxhohen nga persona jo kompetentë.
- Mungon legjislacioni për kualifikimin dhe profilizimin e mjekëve të punës.
- Mungon konsultimi dhe përfshirja e përfaqësuesve të punëmarrësve në çështjet e SSHP-së. Këshillat e Sigurisë e Shëndetit në Punë ngrihen dhe funksionojnë formalisht.
- Ka mungesë të njohjes së legjislacionit dhe ndërgjegjësimit nga punëdhënësit e punëmarrësit mbi çështjet e SSHP-së.
- Nuk ka sistem edukimi për formimin e ekspertëve të SSHP-së.



## Vështirësitë me të cilat përballet ISHPSHSH

- ISHPSHSH duhet të inspektojë të gjithë aktivitetet ekonomike në RSH, por aktualisht me numrin e inspektoreve që ka mbulon me inspektim rreth 5 % te subjekteve aktive të rregjistruara në QKB. Gjithashtu edhe shpërndarja e inspektorëve të punës në shtrirje gjeografike ka nevojë për ndërhyrje.
- Kryerja e inspektimit online, i cili ka përmirësuar ndjeshëm këtë proces, përsëri ka problematikat e veta, ku grupet e inspektimit të cilat minimalisht përbëhen nga dy inspektorë, duhet të punojnë me një paisje portabel, si dhe për arsye teknike në disa raste vështirëson dhe ngadalëson procesin inspektues, ndaj është e nevojshme sigurimi i infrastruktures së duhur për kryerjen e inspektimeve profesionale në të gjithë territorin e Republikës.
- ISHPSHSH në mungesë të një sistemi trajnimi fillestar dhe të vazhdueshëm të inspektorëve të punës, ka ngritur me kapacitetet e vetë institucionit një trupë trajnuese për të gjithë inspektorët e punës.
- Mungon një sistem për mbledhjen dhe raportimin e statistikave të aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale sipas metodave tëBE-së.



## Sfidat e ISHPSHSH-së për zbatimin me efikasitet të Ligjit të SSHP-së.

- Forcimi i sistemit të inspektimit të punës, rritja e transparences dhe luftës ndaj punës informale.
- Orientimi dhe forcimi i kontrolleve në sektorët me risk të lartë për aksidente në punë dhe sëmundje profesionale .
- Rritja e përfshirjes të punëmarrësve në ceshtjet e sigurisë e shëndetit në punë dhe rritja e efektivitetit të Këshillave të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë.
- Propozime për plotësimin e kuadrit ligjor për ngritjen e sistemit të trajnimit dhe certifikimit të ekspertëve të sigurisë e shëndetit në punë.
- Rritja e nivelit profesional të inspektorëve të punës, duke kërkuar ngritjen e sistemit të trajnimit për inspektorët e punës dhe përmirësimi i infrastrukturës të Inspektoratit Shtetëror të Punës.
- Rritja e ndërgjegjësimit të popullatës për ceshtjet e SSHP-se nëpërmjet fushatave sensibiluese në nivel kompanie, rajonal dhe kombëtar.
- Rritja e bashkëpunimit me aktorë të tjerë që operojnë në fushën e SSHP-së, organizatat e punëdhënësve, punëmarrësve, sindikata, shoqërinë civile etj.



# *Faleminderit për vëmendjen tuaj*

